

## A K T - T H E M E L I M I

### I SHOQËRISE “TRISHTIL ” SH.P.K.

Sot, më datë 23 shtator 2024

Zj. **Enxhi Hudhri**, atësia Bujar, amësia Suzana, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, me adresë Gjik Kuqali; Nd. Nd 6; H. Hyrja 4; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 03/04/1994, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftim ID nr. personal J45403075B;

me cilësinë e Ortakut të Vetëm Themelues;

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008, “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare” të ndryshuar, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” me ndryshimet e mëvonshme, si dhe legjisacionin ne fuqi, themelon shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar:

**SHOQËRIA “TRISHTIL” sh. p. k.**

KREU I

NENI 1

KRIJIMI

Shoqëria është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet e procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Kapitali i Shoqerisë ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetëm, që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

### NENI 3

#### SELIA

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Njësia Administrative nr. 6, Rruga Konferenca e Pezes, Ndërtesa Nr. 71, Hyrja 5, Kodi Postar 1027.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hape zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakut të Vetëm.

### NENI 4

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

### NENI 5

#### KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

### KREU II

#### NENI 6

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lekë (dhjetë mijë leke) dhe është i përberë nga 1 kuote e cila është kontribut dhe zotërohet 100% nga Ortaku i Vetëm Enxhi Hudhri.

Kapitali i mësipërm është i nënshkruar tërësisht nga ortaku i vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë:

### NENI 7

#### TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete, qe nuk bëjnë pjese në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rruge trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshorteve.

Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshorteve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**NENI 8**  
**ORGANI VENDIMMARRES**

Ortaku i Vetem është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi vendimmarrës i shoqërisë, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modalitetave të përcaktuara me ligj.

Ortaku u vetëm brenda një afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe illogarite vjetore, te hartuara nga administratori.

**NENI 9**  
**NDRYSHIMET E STATUTIT**

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i Vetëm.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**NENI 10**  
**ADMINISTRIMI**

Administrator i shoqërisë është emëruar Enxhi Hudhri.

Administratori ushtron funksionin e tij për një periudhe kohe 5 vjeçare që nga momenti i emërimit, me të drejtë riemerimi.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

**NENI 11**  
**KOMPETENCAT**

Administratori ka te gjitha kompetencat për te vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave, qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve, që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se te tretët e dinin, që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt

ne rrethanat e dhëna duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratorit nuk i lejohet të marrin hua te shoqëria, të jatin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës ndaj të treteve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Klauzolat e këtij statusi, që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

#### NENI 12

#### VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 01 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë ne QKB dhe mbylltet më 31 Dhjetor.

#### NENI 13

#### SHPËRNDARJA, PRISHJA E SHOQËRISË

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë:

Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë se saj.

Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji “Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare”

Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Me vendim të ortakut të Vetëm.

Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilën parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim”.

#### NENI 14

#### BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plete me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjore në fuqi dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 15  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjtë, në gjuhen shqipe  
dhe pasi miratohet ne parim dhe nen për nen nga Ortaku i Vetëm themelues, nënshkruhet në  
të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën sipas ligjit.

**ORTAKU I VETËM**  
**I SHOQËRISË “TRISHTIL”**

Enxhi Hudhri  
